

## PROGRAMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE VENDORE

<b>Përshkrimi i Programit</b>
Ky program realizon përmirësimin e infrastrukturës vendore nëpërmjet rikualifikimeve të hapësirave publike, shërbimeve publike të pastrimit, gjelbërimit , ndriçimit etj.
<b>Përshkrimi i Politikës së Programit</b>
Politika e këtij programi synon në një përfaqje të integruar të zhvillimit ekonomik të qytetit të Tiranës me përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mbrojtjes së ambientit kundrejt zhvillimit urban të qytetit.
<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>
Kjo politikë ka për qëllim ofrimin me cilësi, sipas standardeve bashkëkohore të shërbimeve publike në të gjithë territorin: 1. Shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta; 2. Shtimin e ambjenteve shlodhëse; argëtuese dhe sportive; 3. Përmirësimin e cilësisë së shërbimit me ujë; 4. Përmirësimin e infrastrukturës së kanalizimeve të ujrave të zeza; 5. Përmirësimin e shërbimit të mbledhjes së mbetjeve urbane; 6. Investimet për shërbimet publike.
<b>Objektivat e Politikës së Programit 2016-2018</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Rikonceptim dhe strukturim i Linjave të transportit urban në Bashkinë e Tiranës sipas ndarjes së re Administrative</li><li>- Biletim elektronik dhe të monitorueshem për transportin urban.</li><li>- Transferimi i gjithë linjave të transportit ndërqytetas dhe ndërkombetare jashtë unazës së mesme dhe me pas deri në ndërtimin e terminaleve përfundimtare.</li><li>- Rehabilitimi i sipërfaqeve të gjelbërta egzistuese;</li><li>- Rikonceptim dhe strukturim i zonave dhe shërbimeve të pastrimit të qytetit në Bashkinë e Tiranës së re Administrative në zonat urbane dhe rurale</li><li>- Ndarje e diferencuar e plerave brenda unazës së mesme.</li><li>- Implementimi me sinjalistike i korsive të autobusëve të transportit urban në unazën e vogël dhe të mesme</li><li>- Krijimi i rrugeteve të korsive të bicikletave në unazën e vogël dhe disa prej rrugëve që lidhen me unazën e mesme</li><li>- Shtimi i ambjenteve shlodhëse, argëtuese dhe sportive;</li><li>- Rikonstrukcioni i kanalizimeve të ujrave të zeza.</li><li>- Shërbimi i ndriçimit të qytetit.</li><li>- Mirëmbajtja e varrezave.</li></ul>
<b>Standardet e Politikës së Programit</b>
Standarde bashkëkohore do të përdoren për të vënë në jetë këtë program në të gjithë territorin e qytetit të Tiranës.

## PROGRAMI I MENAXHIMIT TE RRUGEVE DHE TRANSPORTIT PUBLIK

### **Përshkrimi i Programit**

Ky program siguron përmirësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore dhe asaj të transportit publik, nëpërmjet ndërhyrjeve në rrugë parësore e dytësore dhe mirëmbajtjes në vazhdimësi.

### **Përshkrimi i Politikës së Programit**

Politika e menaxhimit të rrugëve dhe transportit publik synon synon një përfaqje të integruar të zhvillimit ekonomik të qytetit të Tiranës, përmirësimin të jetës së qytetarëve dhe mbrojtjes së ambjentit kundrejt zhvillimit të rrejtët rrugor dhe një transporti publik të shpeshtë, të shpejtë, të besueshëm dhe konfort.

### **Qëllimi i Politikës së Programit**

Kjo politikë ka për qëllim: 1. Zhvillimin e një rrjeti transporti rrugor pa bllokime e ndërprerje, që do të përmirësojë lëvizjes e njerëzve dhe mallrave urbane si dhe aksesin ndaj shërbimeve; 2. Zhvillimin e transportit të qëndrueshëm me rrota dhe shina dhe përdorimin e mjeteve me shkallë të ulët ndotjeje; 3. Zhvillimin e një transporti urban më eficient duke përdorur metoda efikase për menaxhimin e kërkesës dhe sigurimin e një informacioni më të mirë për të rritur lëvizshmërinë ; 4. Rritjen e cilësisë së aksesit ndaj transportit publik jo vetëm për personat me aftësi të kufizuar; 5. Përmirësimin e sigurisë, me synim uljen e numrit të aksidenteve rrugore nëpërmjet përmirësimin të të gjithë instrumentave dhe elementëve të sinjalistikës rrugore në qytet.

### **Objektivat e Politikës së Programit 2016-2018**

- Riparimet e infrastrukturës ekzistuese për të 24 njesite administrative për sipërfaqet asfaltike, sasia e sipërfaqes totale do të jete 48 000 m<sup>2</sup>, rreth 2 000 m<sup>2</sup> për njesi administrative .
- Riparimet e trotuareve ekzistuese për 24 njesite administrative, sasia e sipërfaqes totale do të jete 24 000 m<sup>2</sup> , rreth 1 000 m<sup>2</sup> për njesi administrative
- Implementimi i investimeve për rrugica e blloqe banimi të permasave të vogla.
- Rikualifikimi i rrjetit ekzistues të ndricimit deri me masen 100 % .
- Implementimi i investimeve në ndricim të ri për rrugica e blloqe banimi të permasave të vogla
- Rikualifikimi i sinjalistikës horizontale dhe vertikale
- Ndërtimi i terminaleve të transportit multifunksionalë;
- Zgjerimi i mbulimit të territorit të qytetit me transport publik;
- Përmirësimi i infrastrukturës së stacioneve të autobuzëve;

### **Standardet e Politikës së Programit**

Standardet e sigurisë rrugore janë në përputhje me Kodin Rrugor dhe Rregullorja për Zbatimin e Kodit Rrugor. Standardet minimale për ofrimin e shërbimit të transportit urban të udhëtarëve janë në përputhje me Urdhrat e Kryetarit të Bashkisë për çdo linjë transporti qytetës. Përcaktimi i linjave të reja bëhet sipas studimeve të kryera nga Bashkia e Tiranës

## PROGRAMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE EDUKIMIT

<b>Përshkrimi i Programit</b>
Programi i Arsimit Parauniversitar edhe Edukimi siguron përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës arsimore dhe kushteve të mësimdhënies.
<b>Përshkrimi i Politikës së Programit</b>
Politika e programit të Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit, ka si prioritar, propozimin dhe hartimin e projekteve të Qeverisjes Vendore për ndërtimin e godinave të reja shkollore dhe parashkollore në të gjithë territorin e Tiranës të destinuar si sheshe të lira, për shkak të rritjes së demografisë dhe zhvillimit ekonomik e social duke synuar kështu rritjen e kapaciteteve të arsimit të përgjithshëm parashkollor e shkollor dhe nevojën për shtimin e kapaciteteve të arsimit profesional e atij universitar.
<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>
Programi i Arsimit Parauniversitar edhe Edukimi ka për qëllim hartimin e politikave për përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe kushteve të mësimdhënies.
<b>Objektivat e Politikës së Programit 2016-2018</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Rikonstruktion i objekteve arsimore parauniversitare.</li><li>- Ndërtimi i objekteve të reja arsimore parauniversitare</li><li>- Mobilimi i objekteve arsimore parauniversitare me të gjithë elementët për një proces mësimdhënie cilësor.</li><li>- Pajisja e objekteve arsimore parauniversitare me sisteme ngrohje.</li><li>- Pajisja e objekteve që rikonstruktohen me palestra, terrene sportive, laboratorë, etj</li><li>- Mirëmbajtje e ambienteve në objektet arsimore parauniversitare</li><li>- Realizimi i lehtësirave për fëmijët me aftësi të kufizuar.</li><li>- Akses të lirë në internet wireless jo vetëm në shkolla por në të gjithë hapësirën e qytetit për të gjithë qytetaret.</li><li>- Aplikimi i sistemit të bursave për nxënësit e dalluar.</li><li>- Organizimi i shkollave verore për zonat informale apo fëmijët në familjet me probleme sociale.</li><li>- Krijimi i klasave të integruara për fëmijët e rrugëve e të atyre jashtë sistemit arsimor.</li><li>- Ofrimi i aktiviteteve të shumta kulturore e artistike për nxënësit dhe nga vetë nxënësit.</li><li>- Orientimi i nxënësve që mbarojnë arsimin bazë drejt një arsimit të mesëm profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës</li></ul>
<b>Standardet e Politikës së Programit</b>
Kushte të përmirësuara të sistemit parauniversitarë dhe edukimit, orientim drejt një sistemi modern në dije dhe informacion të të gjithë nxënësve, studenteve dhe qytetarëve si dhe bashkëpunimit intensivisht me botën universitare.

## PROGRAMI I KUJDESIT SOCIAL

<b>Përshkrimi i Programit</b>
Ky program siguron përmirësimin e infrastruktures së çerdheve të qytetit dhe trajton problemet sociale të shtresave në nevojë.
<b>Përshkrimi i Politikës së Programit</b>
Programi i Kujdesit Social realizon hartimin e politikave sociale lokale në funksion të forcimit të mirëqenies sociale dhe ekonomike të kategorive në nevojë dhe të komunitetit në përgjithësi si dhe kujdesin për fëmijët në çerdhet e qytetit.
<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>
Koordinimi i përpjekjeve të qeverise vendore dhe organizatave ofruese të shërbimeve për ndërtimin e një sistemi shërbimesh sociale me bazë komunitare, i cili do të mbulojë problematikat e një numri të madh grupesh dhe individësh në nevojë. Krijimi i kushteve optimale për mirërritjen e fëmijëve në çerdhe.
<b>Objektivat e Politikës së Programit 2016-2018</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Rritja e numrit të individëve (fëmijë në situatë rruge, të moshuar, familje në nevojë, persona me aftësi të kufizuar) që përfitojnë shërbime nga strukturat e shërbimit social në Bashkinë e Tiranës (qendra sociale, mensat sociale, programe sociale me fokus punësim-strehim-përfshirjen sociale) përmes ndërtimit të sistemit funksional të shërbimeve.</li><li>- Ngritja e Qendrave Sociale Multifunkionale për të mbuluar shërbimin për të moshuarit, të rinjtë dhe familjen për të ndërtuar një rrjet shërbimesh në nivel komunitar.</li><li>- Shtimi i politikave të nxitjes së punësimit formimit profesional dhe sipërmarrjes për të rinjtë dhe gratë me anë të organizimeve si panairë pune dhe bashkëpunime me sipërmarrjet dhe programet sociale mbështetëse.</li><li>- Ngritja dhe fuqizimi i Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve (NjMF) në cdo Njësi Administrative, përmes shtimit të numrit të punonjësve dhe rritjes së kapaciteteve njerëzore për funksionimin e mekanizmit të vlerësimit dhe veprimit për fëmijët në situatë rrezikshmërie të lartë</li><li>- Mobilimi i çerdheve me orenditë dhe paisjet e duhura për rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar në çerdhe.</li><li>- Rikonstrukcioni i godinave ekzistuese të çerdheve dhe ndërtimi i çerdheve të reja dhe i kopshteve të integruara (kopshte e çerdhe); Pajisja e çerdheve me sisteme ngrohje qendrore dhe sistemet MNZ; Paisja e çerdheve me të gjitha ambientet e duhura për të siguruar zhvillimin konjitiv, zhvillimin social, zhvillimin gjuhësor, zhvillimin motor të fëmijëve; Pajisja e çerdheve me kënde lojrash, kënde sportive, sipërfaqe të gjelbërta si dhe mirëmbajtje e vazhdueshme e ambienteve të çerdhes.</li><li>- Realizimi i lehtësirave për fëmijët me aftësi të kufizuar.</li><li>- Lehtësira dhe përjashtime nga pagesat në çerdhe/kopshte për grupet e fëmijësh e familjesh në nevojë.</li><li>- Rritja e sigurisë fizike në çerdhe si një prej elementëve më të rëndësishëm për fëmijët.</li><li>- Integrimi i programeve të specializuara për edukimin e fëmijëve, i ndarë sipas grupmoshave, latantë dhe grupe mikse, në përputhje me zhvillimin e tyre biologjik dhe psiko-emocional. Paisja e çerdheve me ekip multidisiplinar (psikolog, punonjës social, mjek pediatër dhe animator).</li></ul>
<b>Standardet e Politikës së Programit</b>
Rritja e mirëqenies sociale përmes zbatimit të programeve të përkujdesit social që parashikojnë ngritjen e qendrave të reja ditore sipas standarteve bashkëkohore dhe ofrimit të shërbimeve sociale që rrisin cilësinë e jetesës së qytetarëve të Tiranës.

## PROGRAMI I STREHIMIT DHE PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

<b>Përshkrimi i Programit</b>
Ky program siguron zhvillimin e qëndrueshëm të territorit nëpërmjet planifikimit urban sipas standardeve bashkëkohore si dhe trajtimin e problemit të strehimit për shtresat e caktuara në nevojë.
<b>Përshkrimi i Politikës së Programit</b>
Zhvillimi i qëndrueshëm urban dhe zbutja e problemit të strehimit për shtresat në nevojë nëpërmjet ofrimit të shanseve të barabarta.
<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>
Zhvillim i qëndrueshëm urban dhe sigurimi i strehimit të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit.
<b>Objektivat e Politikës së Programit 2016-2018</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Zhvillim urban i qëndrueshëm, me qëllim që t'i hapë rrugë zhvillimit ekonomik dhe mjedisor të Tiranës duke nxitur edhe hapjen e vendeve të reja të punës</li><li>- Harmonizimi i interesave publike dhe interesave private që do të rezultojë në mbrojtjen e hapësirave publike dhe atyre të gjelbra</li><li>- Hartimi i planeve të detajuara vendore për zberthimin e planit përgjithshëm vendor dhe kontrollit të zhvillimit të vazhdueshëm të hapësirave urbane të qyteti</li><li>- Përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve përmes ofrimit të një strehimi të përshtatshëm për familjet si kategori prioritare dhe të tjerave në nevojë për strehim.</li><li>- Bashkëpunim me organizatat që mbrojnë të drejtat e grupeve në risk, komuniteti rom, nënat kryefamiljare etj, për identifikimin e nevojave për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm nga ana e tyre</li><li>- Përmirësim i cilësisë së shërbimeve për qytetarët</li><li>- Evidentimi i objekteve të dala jashtë funksionit me mundësinë e përdorimit të tyre për strehim social</li><li>- Zbatim i programit të banesave me kosto të ulët, për familjet e klasifikuara si prioritare dhe të tjerave në nevojë për strehim, përmes kreditimit me interes të ulët</li><li>- Aplikim i bonusit të strehimit për familjet me të ardhura të pamjaftueshme për ta përballuar qiranë e tregut, kur familja e ka apartamentin pranë vendit të punës, shkollës, qendrave shëndetësore, etj.</li><li>- Zbutja e problemi të strehimit përmes shpërndarjes së banesave sociale me qira, sipas përcaktimit në ligjin për strehimin</li></ul>
<b>Standardet e Politikës së Programit</b>
Rritja e standartit të jetesës mbështetur në planin 10-vjeçar të strehimit, për një strehim të përshtatshëm jo vetëm të grupeve në risk, por edhe familje të tjera të cilat kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi.

## PROGRAMI PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIM

### Përshkrimi i Programit

Ky program percakton menaxhimin dhe mbeshtetjen administrative per programet e tjera, vecanerisht ne vazhdimesine e zhvillimit te kapaciteteve menaxhuese ne te gjitha nivelet e institucionit per te mundur pergatitjen, zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe kuadrit ligjor

### Përshkrimi i Politikës së Programit

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Bashkisë së Tiranës, zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese dhe në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Bashkisë.

### Qëllimi i Politikës së Programit

Ky program parashikon menaxhimin financiar të Bashkisë së Tiranës dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për funksionimin normal të administratës vendore dhe përmbushjen e misionit të bashkisë së Tiranës për mobilizimin dhe përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të burimeve financiare publike, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, të politikave të mandatuara.

### Objektivat e Politikës së Programit 2016-2018

- Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Bashkisë së Tiranës dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes në varësi të saj nëpërmjet trajnimeve
- Hartimi dhe propozimi i ndryshimeve në politikën fiskale, me qëllim mbështetjen e vazhdueshme të rritjes ekonomike të qytetit.
- Ndërtimin e një sistemi efektiv të programimit buxhetor, mbi bazë programesh, për të gjitha institucionet buxhetore; Përfitimi i huamarrjes publike nëpërmjet një menaxhimi aktiv me bazë koston dhe riskun; Forcimi i auditimit mbi bazën e riskut.
- Përmirësimi i menaxhimit dhe përdorimit të fondeve publike me transparencë, efikasitet, ekonomike dhe implementimin e zhvillimit në një sistemi bashkëkohor e të qëndrueshëm për kontrollin e brendshëm financiar, me një shërbim të pavarur e funksional të auditimit të brendshëm.
- Krijimi i një institucioni efikas, ku të përmirësohen në vazhdimësi aftësitë e stafit drejtues, kapacitetet institucionale dhe teknike, me qëllim administrimin korrekt të fondeve,
- Të asistohen dhe nxiten tatimpaguesit në mënyrë që të likuidojnë detyrimet në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor.
- Të sigurohet zgjerimi i bazës së taksueshme, rritja e numrit të taksapaguesve, dhe reduktimi i elementëve të evazionit.
- Krijimi i sistemit të informacioni, nëpërmjet informatizimit dhe lidhjes online ndërmjet strukturave bashkiake dhe bankave të nivelit të dytë, si dhe për ofrimin e shërbimit ndaj taksapaguesve, në mënyrë elektronike, për një shërbim të ndershëm, të plotë dhe cilësor për biznesin dhe qytetarët.
- Fushata informative dhe sensibilizuese për ndërgjegjësimin e publikut për detyrimet ligjore ndaj Bashkisë.
- Përmirësimi i ambjenteve të punës për punonjësit e Bashkisë, mirëmbajtja e sistemit kompjuterik dhe faqes së internetit të Bashkisë së Tiranës për pasqyrimin me transparencë të punës së Bashkisë së Tiranës.
- Përmirësimi i legjislacionit vendor dhe përafrimi i tij me standardet e BE, lidhur me menaxhimin e mjedisit, parkimet mbitokësore e nëntokësore, administrimin e ndërtesave, si dhe në fushën e planifikimit territorial.

## PROGRAMI I KULTURËS DHE TURIZMIT

<b>Përshkrimi i Programit</b>
Ky program siguron shtimin dhe gjallërimin e jetës artistiko – kulturore të qytetit të Tiranës.
<b>Përshkrimi i Politikës së Programit</b>
Politika e këtij programi synon krijimin e një jete sa më të pasur kulturore dhe sociale për qytetin e Tiranës duke përfshirë të gjitha grupmoshat dhe nivelet e ndryshme sociale që bashkëjetojnë në Tiranë dhe promovimin e një qyteti sa më tërheqës dhe konkurrues për tregun e biznesit dhe të vizitorëve.
<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>
Programi i kulturës dhe artit do të tentojë t'i japë një dimension të ri dhe më të plotë jetës artistike dhe kulturore të kryeqytetit jo vetëm duke u mbështetur në rivitalizimin e mëtejshëm të projekteve ekzistuese, të cilat janë kthyer tashme në një traditë për qytetin e Tiranës, por edhe duke dhënë hapësira të reja për projekte të tjera inovative të cilat vijnë pranë Bashkisë së Tiranës nga persona të tretë, shoqëria civile apo ente të tjera kombëtare e ndërkombëtare. Ky program do të tentojë të promovojë vlerat kulturore të qytetit c'ka do ta bënte jo vetëm për qytetarin e Tiranës, por dhe vizituesin e saj, me atraktiv.
<b>Objektivat e Politikës së Programit 2016-2018</b>
<i>Në fushën e zhvillimit të kultures:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- Krijimi dhe realizimi “Tirana International Arts Festival” . Ne Festival do te prezantohen artiste te rinj vendas dhe te huaj duke u fokusuar ne fushat kryesore</li><li>- Krijimi i nje “Network arti &amp; kulture Rajonal” midis kryeqyteteve te Ballkanit i cili do te stimuloje shkembimet artistiko &amp; kulturore, do te promovojë Tiranen ne nivel Ballkanik si dhe nivel BE, duke synuar stimulimin artet moderne.</li><li>- Rritjen e cilësisë së praktikave kulturore të qytetarit të Tiranës nëpërmjet ofrimit të projekteve artistike e kulturore inovative me një cilësi të lartë e bashkëkohore.</li><li>- Rivitalizimi i objekteve historike e kulturore me forma të ndryshme të kreativitetit si shprehje e identitetit të kryeqytetit.</li><li>- Të ofrojë sa më shumë aktivitete, të cilat lidhen me programin e kulturës dhe të artit, për t'i paraqitur në Këshillin Artistiko-Kulturor, të ardhura pranë Bashkisë së Tiranës, duke parë mundësitë më të mira për shtimin e impaktit.</li><li>- Të organizojë sipas kalendarit festat e traditës, të ditëve kombëtare e ndërkombëtare, aktivitete derivate të binjakëzimeve si dhe të iniciojë aktivitete inovative masive dhe elitare duke evidentuar ndër to aktivitetet që do të jenë specifike për Tiranën</li><li>- Të iniciojë hapjen dhe funksionimin e qendrave multimediale në njësitë administrative</li><li>- Të identifikojë, vlerësojë, konservojë dhe rehabilitojë të gjitha vlerat e trashëgimisë kulturore, monumentet e kulturës, traditën folklorike, artizanatin etj, për të rritur destinacionet turistike në qytet dhe për të mbrojtur vlerat kombëtare, në bashkëpunim me institucione e organizma të specializuara.</li></ul>
<i>Në fushën e zhvillimit të turizmit:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- Promovimi dhe Informimi i Aseteve Turistike. Vendosja e disa tabelave informuesenë dy gjuhë (edhe me QR code) në çdo monument, tabela orientuese, fletëpalosje, trajnim i guidave lokale si dhe organizim i eventeve të ndryshme në këto site.</li><li>- Krijimi i itinerarit Turistiko Kulturor. Krijimin e një rrjeti infrastrukturor të posaçem për vizitorët të cilët kanë dëshirë ta bëjnë në këmb (trekking), me kafshë (kuaj, mushka) pistë për biçikletat, si dhe vënie në dispozicion të një trasporti publik i cili të çon afër asetëve turistike (monumente kulture, resurse natyrore, etj).</li></ul>
<b>Standardet e Politikës së Programit</b>
Aktiviteti i drejtorisë është i organizuar dhe zhvillohet në bazë të përvojës së vendeve të Komunitetit European. Implementimi i ketyre objektivave do te sjellë përmirësim e jetës së qytetarit, dhe terheqjen e turistëve. Nga këto aktivitete do të përfitojnë qytetaret e Tiranës ne aktivitetet masive, artistet e njohur dhe te rinj si dhe krijimi i nje imazhi pozitiv te Kryeqytetit te Shqiptareve ne mbare arenen nderkombetare.

## PROGRAMI I RINISË DHE SPORTIT

### **Përshkrimi i Programit**

Programi i rinisë dhe sportit parashikon organizimin e aktiviteteve të ndryshme rinore dhe sportive në qytetin e Tiranës.

### **Përshkrimi i Politikës së Programit**

Kthimi i Tiranës në një qytet të pasur me aktivitete rinore, sportive dhe kulturore si dhe krijimi i një stili modern jetese për sa i përket mirëqënies psiko-fizike.

### **Qëllimi i Politikës së Programit**

Politikat kryesore të programit për Rininë dhe Sportin janë të lidhura ngushtë me organizmin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve dhe projekteve të ndryshme rinore për të bërë të mundur rivitalizimin e rinisë jo-aktive të Tiranës si dhe nxitjen, zhvillimin dhe përhapjen e kulturës sportive në kryeqytet nëpërmjet organizimit të aktiviteteve dhe projekteve sportive. Krijimi i një partneriteti të fortë dhe multifunksional me të rinjtë e kryeqytetit nëpërmjet marrjes së iniciativave për krijimin e sa më shumë lehtësirave për të rinjtë, organizimin e sa më shumë programeve sportive dhe rinore.

### **Objektivat e Politikës së Programit 2016-2018**

*Në fushën e zhvillimit të rinisë:*

- Përfshirje e të rinjve në procesin e politikbërjes dhe rritje e kapaciteteve të burimeve njerëzore ( Kultura e vullnetarizmit). Krijimin e programeve specifike ku nëpërmjet bashkëpunimit synohet rritja kapaciteteve të të rinjve që të përfshihen në vendimarrje lokale si qytetar aktiv dhe vullnetar.
- Përdorimi i hapësirave të shkollave publike si Qendra Komunitare për implementimin e programeve të ndryshme, me qëllim strategjik krijimin e modelit të Qendrave Rinore pranë njësive administrative.

*Në fushën e zhvillimit të sportit:*

- Realizimi i projektit për krijimin e klasave sportive pranë shkollave, të cilat i kanë strukturat që mundësojnë realizimin e promovimit të iniciativave Sportive
- Vendosja e bazave për krijimin e klasave sportive, të cilat do të jenë burim për aktivizimin e nxenesve të shkollave në projektet sportive, çka ben të mundur krijimin e nje baze te gjere per formimin e brezit te sportistave te ardhshem.
- Fuqizimi i organizimit të eventeve sportive rinore , përmes përkrahjes së projekteve të cilat bëjnë të mundur rritjen e jo vetem të pëfshirjes së rinisë shkollore dhe studentore në realizimin e tyre por edhe të një numri të madh të të rinjve të cilët nuk janë të inkuadruar në asnjë aktivitet ose që kanë qasje të kufizuara në aktivitetet sportive
- Dizajnimi i programeve në nivel qyteti, të cilat do të implementohen me një bashkëpunim të ngushtë në mes të federatave sportive dhe rinisë shkollore.

### **Standardet e Politikës së Programit**

Veprimtari e koordinuar; Bashkëpunim ndërmjet strukturave vendore dhe qendrore; Transparencë; Përfshirja qytetare në politikat e qeverisjes; Sisteme elektronike të përparuar dhe të unifikuara; Shërbime të standartizuara, të pavarura nga platformat e përdorura dhe teknologjitë, të thjeshta në përdorim.



## PROGRAMI I RENDIT DHE MBROJTJES CIVILE

### **Përshkrimi i Programit**

Programi i Rendit dhe Mbrojtjes Civile parashikon funksione në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.8224, datë 15.05.1997 dhe që nuk janë në kompetencë të autoriteteve të tjera shtetërore.

### **Përshkrimi i Politikës së Programit**

Garantimi i përmbushjes së funksioneve të përcaktuara me akte ligjore në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike brenda territorit të bashkisë.

### **Qëllimi i Politikës së Programit**

Ruajtja e rendit publik për parandalimin e shkeljeve administrative e garantimin e zbatimit të akteve të Bashkisë që i shërbejnë ruajtjes së pasurisë së Bashkisë e të mjedisese publike, zhvillimit normal të jetës ekonomike e sociale në qytet si dhe garantimin e shërbimit në rastet e fatkeqësive natyrore.

### **Objektivat e Politikës së Programit 2016-2018**

- Të sigurojë zbatimin efektiv të urdhërave të nxjerra nga kryetari i bashkisë dhe të vendimeve të këshillit që kanë të bëjnë me sigurimin e rendit e të qetësisë dhe mbarëvajtjen e punëve publike.
- Të marrë masa për ruajtjen e pasurisë së bashkisë si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj.
- Të sigurojë zbatimin e urdhrave të nxjerra nga kryetari i bashkisë në lidhje me personat juridikë ose fizikë, që nuk plotësojnë konform ligjit detyrimet financiare e fiskale, ndaj bashkisë, si dhe çdo detyrim tjetër pasuror ndaj tyre.
- Të mbikëqyrë e verifikojë nëse shtetasit në administrim të pasurisë së tyre, zbatojnë ose plotësojnë kërkesat e akteve bashkiake.
- Të konstatojë e të parandalojë ndotjet e mjedisit, hedhjet e mbeturinave të ndryshme, si dhe të sinjalizojë kryetarin e bashkisë për rastet kur shendetit publik është në rrezik.
- Të ndalojë, shmangë e prishë ndërtimet e paligjshme, të ndalojë zëniet e paligjshme të trojeve dhe të ndërtesave e objekteve publike të bashkisë si dhe të organizojë lirin e tyre.
- Të kujdeset për qetësinë publike, duke shmangur dhe mënjanuar zhurmat e shkaktuara nga faktore të ndryshme në rrugë, ambiente publike etj.
- Të marrë masa për ruajtjen e rendit, kur ka grumbullime njerëzish, si në tregje, panairë, ceremoni publike, artistike, fetare e sportive, në kinema, teatro, pallate e salla sportive, objekte të kultit dhe në mjedise të tjera publike.
- Të inspektojë tregjet, të kontrollojë zënien e vendeve për tregti ambulante, të verifikojë pajisjen me licensë të tregtarëve dhe personave të tjerë që merren me veprimtari shitblerje, me tregtimin e pijeve alkoolike, objekteve me vlera artistike e kombëtare, të lëndëve djegëse, të kontrollojë respektimin e masës, peshës dhe çmimit e shitjes.
- Të kontrollojë marrjen e masave të sigurisë që parandalojnë fatkeqësitë e ndryshme natyrore si dhe të ndihmojë në kapërcimin e tyre duke u dhënë gjithashtu ndihmë të dëmtuarve në raste urgjence.
- Të sigurojë zbatimin rigoroz të dispozitave ligjore të kodit rrugor (sipas ndryshimeve të bëra në vitin 2007) ku përcaktohen shkeljet si parkimet e paligjshme në trotuare, parkime dyshe, stacionet e autobuzëve, parkimet e gabuara pranë vendodhjes së kontenerëve, etj.